



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raporti i Vlerësimit Institucional të
Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës**

Dhjetor 2016

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	Error! Bookmark not defined.
Konteksti i këtij vlerësimi	Error! Bookmark not defined.
Raport i përmbledhur	Error! Bookmark not defined.
Përmbledhje e gjetjeve.....	Error! Bookmark not defined.
Përmbledhje e gjykimeve	Error! Bookmark not defined.
Raport i detajuar	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi .	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	Error! Bookmark not defined.

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi i jashtëm institucional është një proces i vlerësimit me ekspertë të jashtëm, ku çdo grup ekspertësh përbëhet nga ekspertë të Mbretërisë së Bashkuar, të përzgjedhur dhe caktuar nga QAA-UK dhe nga ekspertë shqiptarë të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një vlerësues i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-ja, por edhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët se si IAL-ja i përmbush standardet. Ky raport, i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë përparësitë për përmirësime (procesit që ofruet e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënimit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar nën pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave më të mira, rekomandimet, pohimet e veprimtarisë në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupin e Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Grupi i Vlerësimit

Z. Grant Horsburgh	Kryetar
Profesor Jeremy Bradshaw	Anëtar
Profesor Sherif Bundo	Anëtar
Dr. Alketa Grepcka	Anëtare
Z. Stephen Harris	Anëtar
Profesor Jethro Newton	Anëtar

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (UAMD) u themelua në vitin akademik 2006-2007, dhe gjatë vitit të parë, u regjistruan 1,000 studentë pothuajse nga të gjitha qarqet e vendit. Fillimisht, Universiteti u hap me tre fakultete: Fakultetin e Edukimit, Fakultetin e Ekonomisë dhe Administrimit, dhe Shkollën e Lartë Profesionale. Që prej themelimit, UAMD është menduar të ishte universitet ndryshe, i cili do të sillte përvojat më të mira akademike Perëndimore të organizimit, jetës universitare dhe programeve të studimit. Kjo i vendos studentët në qendër të vëmendjes në të gjitha veprimtaritë dhe proceset.

Që në fillimet e tij, UAMD-ja ka funksionuar sipas parimeve të Kartës Evropiane dhe ka zbatuar një ndërthurje me Sistemin Amerikan të Krediteve (USCr). Ky sistem i pajis studentët me diplomë që njihet në të gjithë botën dhe që mund t'iu mundësojë studime të mëtejshme dhe mundësi punësimi. Universiteti e lëshon diplomën në gjuhën shqipe dhe angleze dhe vlerat e krediteve shprehen me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe me Sistemin Amerikan të Krediteve (USCr). Një tjetër karakteristikë kryesore e universitetit është angazhimi me komunitetin vendor për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e zhvillimit rajonal.

Universiteti është zgjeruar mjaft që prej themelimit të tij para 10 vjetësh. Në kohën e këtij vlerësimi, UAMD-ja kishte rreth 10.000 studentë dhe ofronte 80 programe studimi për të tre ciklet. Universiteti ka 270 pedagogë me kohë të plotë të organizuar në gjashtë njësi kryesore, si më poshtë: Fakulteti i Biznesit; Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike; Fakulteti i Edukimit; Fakulteti i Studimeve Profesionale; Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit; dhe Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën.

Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën u themelua në vitin 2008, si produkt i një projekti të përbashkët midis qeverisë shqiptare dhe asaj gjermane. Fakulteti funksionon mbështetur në modelin e akademive profesionale në Republikën Federale të Gjermanisë dhe universiteti e konsideron si risi dhe të veçantë. Gjithashtu, Fakulteti i Studimeve Profesionale, ish Shkolla e Lartë Profesionale, ka ngjashmëri institucionale me “universitetet që ofrojnë diploma dy vjeçare”, dhe ofron diploma me profil profesional.

Raport i përmbledhur

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (UAMD) është institucion publik, me godina në qytetin e Durrësit. Universiteti u themelua në vitin akademik 2006-2007 dhe në kohën e këtij vlerësimi kishte rreth 10.000 studentë dhe ofronte 80 programe studimi për të tre ciklet. Universiteti ka 270 pedagogë me kohë të plotë të organizuar në gjashtë njësi kryesore, si më poshtë: Fakulteti i Biznesit; Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike; Fakulteti i Edukimit; Fakulteti i Studimeve Profesionale; Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit; dhe Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën.

Një grup nga universiteti, që përfshinte drejtues të nivelit të lartë, staf akademik dhe personel mbështetës, dhe një përfaqësues të studentëve, përpiloi raportin e vetëvlerësimit. Projekt raportet iu shpërndanë një audience të gjerë në universitet përpara përfundimit dhe miratimit nga Rektorati dhe Senati Akademik.

Vizita zgjati dy ditë, në datat 19 dhe 20 shtator 2016. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga katër ekspertë të nivelit të lartë për arsimin e lartë nga Mbretëria e Bashkuar dhe nga dy anëtarë me përvojë në arsimin e lartë nga personeli i institucioneve shqiptare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mbështetej nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një mbajtës shënimesh të caktuar nga APAAL-i. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, të javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuar më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë. Një gamë e gjerë informacioni mbështetës siguroar nga universiteti i mundësoi ekipit të njëjtit me strukturën, politikën dhe procedurat e administrimit, dhe me mënyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të zbatuar nga institucioni. Të dhënat përfshinin Statutin e Universitetit, Rregulloret Akademike, Raportet Vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, listë të marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumëve, shembuj të informacionit mbi programin dhe dokumentacion të mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtues të nivelit të lartë, studentë, pedagogë, personelin mbështetës dhe administrativ, si dhe partnerë të jashtëm dhe punëdhënës. Diskutimi shërbeu për sqarimin e procedurave, përgjegjësive dhe pikëpamjeve. Gjatë takimeve u mbajtën shënime. Si pjesë të turit të kampusit kryesor, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, ambientet e mësimdhënies, laboratorët, dhe zyrat.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht. UAMD-ja funksionon në përputhje me kërkesat e Statutit të tij (2011) dhe me Rregulloren e Brendshme (2012) dhe është organizuar për të siguar drejtim efikas, dhe marrëveshjet ekzistuese dhe të ardhshme për drejtimin dhe administrimin e Universitetit, dhe për vendimmarrjen kolegjiale, zbatohen në mënyrë të përshtatshme dhe kuptohen nga personeli në të gjitha nivelet. Megjithatë, Universiteti nuk i përdor në mënyrë të efektshme raportet dhe të dhënat për çështjet e cilësisë, dhe informacionet dhe rezultatet e përfuara nga anketimet e studentëve. Gjithashtu, nuk ekzistojnë mekanizma formalë që të pajisin komunitetin e gjerë akademik me informacion mbi veprimet e ndërmarra nga Rektorati ose Senati Akademik, bazuar në analizat e të dhënave të raporteve dhe anketimeve. Për më tepër, Universiteti, fakultetet dhe departamentet nuk i njoftojnë studentët për veprimet e ndërmarra si përgjigje ndaj feedback-ut të tyre. Universiteti mbështet diskutimet dhe debatet në organet e tij kolegjiale. Bordet dhe Këshillat e universitetit mbledhen rregullisht dhe informacionet për pikat e axhendes iu jepen paraprakisht. Universiteti sigurohet që kufijtë e autonomisë së tij të respektohen dhe që ai ta ushtrojë autonominë e tij sipas dispozitave të legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi. Vetëqeverisja në marrëdhëniet institucionale përfshin të gjitha njësitë organizative akademike dhe administrative, veprimtaritë e mësimdhënies dhe shkencore, çështjet financiare dhe administrative, dhe miratimin e marrëveshjeve institucionale me organe të jashtme. Ndërgjegjësimi i personelit lidhur me procesin dhe dokumentacionin e planifikimit institucional është i përshtatshëm dhe ofrohen mundësi për diskutimin dhe

përfshirje në faza të ndryshme, si në organet e administrimit ashtu edhe në këshillat vendimmarrëse. Stafi akademik ka pavarësi, për sa i përket organizimit të veprimtarive akademike në mësimdhënie, punë kërkimore, dhe lidhur me kurrikulën e programeve të studimit. Megjithatë, nevojiten përmirësime në fushën e kërkimeve të aplikuara për doktoraturë dhe duhet të përforcohet dhe të zgjerohet niveli i kërkimeve shkencore të aplikuara të lidhura me tregun, që janë ndërmarrë nga kandidatët për doktoraturë. Universiteti pohon se jo të gjitha fakultetet janë mjaftueshëm aktive për sa i përket studimeve të tregut e punës dhe thekson se kjo çështje ka nevojë për përmirësim. Studentët, të diplomuarit dhe punonjësit e vlerësojnë punën e Degës së Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit dhe proceset e përdorura për ndjekjen punësimit të të diplomuarve, si për shembull, me anë të anketimeve të rregullta dhe shumë forma të tjera të komunikimit me punëdhënës dhe partnerë të tjerë vendor dhe rajonal, që përbën praktikë të mirë. Volumi aktual i veprimtarive ndërkombëtare është modest si në punën me projekte, ashtu edhe në mobilitet.

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht. UAMD-ja ka një organigramë të qartë, e shpallur në faqen e internetit të universitetit dhe që përshkruan përgjegjësitë për administrimin e burimeve njerëzore. Politikat dhe procedurat e universitetit në mënyrë të efektshme mbështesin dhe udhëzojnë punësimin me kohë të plotë dhe të pjesshme të një personeli të kualifikuar, që përmbush kërkesat akademike dhe administrative të universitetit. Me ndihmën e DURSAK, një organizatë që përfaqëson qytetarët e Durrësit, UAMD-ja, në bashkëpunim me komunitetin vendor, organizon aktivitete kulturore për personelin dhe studentët. UAMD-ja ka mekanizma të brendshëm për vlerësimin e stafit akademik dhe çdo departament është përgjegjës për administrimin e procesit. Megjithatë, ekzistojnë metoda të ndryshme për vlerësimin formal të mësimdhënies në universitet, që më shumë përqendrohen në identifikimin e problemeve, se sa në qasjen zhvillimore. UAMD-ja ka një politikë zhvillimi të qëndrueshëm dhe të efektshëm shoqëror dhe në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Durrës, po ndërmerr disa nisma mjedisore. UAMD-ja ka procedura transparente dhe të përshtatshme për administrimin e burimeve financiare, që parashikohen dhe administrohen në përputhje me standardet dhe rregulloret e administrimit të financave publike, dhe i dorëzon Ministrisë raportet përkatëse vjetore. Infrastruktura e teknologjisë së informacionit në UAMD përfshin kompjuterë, laboratorë kompjuteri, fotokopje, printera, skanerë, projektorë, programe të përgjithshme dhe të specializuara dhe internet të shpejtë me bandë të gjerë dhe Wi-Fi. Gjithsej ka tre biblioteka, nga një në secilën godinë kryesore të universitetit, dhe që të gjitha kanë mundësinë e kërkimit të bibliografive përmes internetit. Biblioteka është pjesë e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike të Shqipërisë dhe kjo u mundëson personelit dhe studentëve akses në shumë libra, qofshin në format të shtypur apo në internet, karakteristikë kjo e praktikës së mirë.

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht. Ofrimi i shërbimeve në UAMD-së është në përputhje me të tre ciklet e studimeve sipas sistemit të Bolonjës dhe programet e studimit ofrohen në përputhje me prirjet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. UAMD-ja ka për qëllim të bashkërendojë ofrimin e shërbimeve me kërkesat e tregut dhe me përparësitë dhe strategjitë vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe procesi i vlerësimit të programit dhe rishikimi i kurrikulës janë në përputhje me Rregulloret e Sigurimit të Cilësisë së universitetit. Një tjetër praktikë e mirë është sigurimi i orareve dhe i informacioneve për syllabusin në internet. Studentët raportuan se i janë ofruar një sërë mundësish për të marrë pjesë në praktika dhe praktika profesionale dhe thanë se universiteti i ka mbështetur mirë. Lidhjet e ngushta të universitetit me alumnit dhe me punëdhënësit ofrojnë më shumë mundësi për praktika profesionale dhe praktika. Studentët, të diplomuarit dhe punonjësit e vlerësojnë shkallën e lartë të përkushtimit të universitetit me organet e jashtme për zhvillimin e kurrikulës, ofrimin e praktikave dhe praktikave profesionale dhe të mundësive të punësimit për të diplomuarit e tij, karakteristika këto të praktikës së mirë. Një shembull i kësaj qasjeje, por jo i vetmi, është ai i Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht. UAMD-ja ka mekanizmat e duhura për të siguruar organizimin dhe dokumentimin e efektshëm të programeve të studimit, dhe politikat dhe mekanizmat e efektshme për të siguruar vlerësimin e rregullt të pedagogëve. Studentët marrin pjesë në procesin e vlerësimit. Universiteti ka vënë në zbatim një strukturë të përshtatshme mbështetjeje për të promovuar përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Drejtimi i punës kërkimore dhe shkencore bëhet në nivel universiteti nga Zëvendës Rektori. UAMD-ja mbështet dhe nxit kërkimet shkencore, që mundësojnë zhvillimin strategjik të vendit, të qarkut dhe të qytetit të Durrësit. UAMD-ja nxit grupe dhe projekte kërkimore në nivel kombëtar, rajonal dhe Evropian. UAMD-ja ka hartuar një politikë që parashikon përparësitë e kërkimit shkencor, që përqendrohen në fusha me interes të posaçëm për vendin, qarkun, qytetin dhe universitetin.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht. UAMD-ja është aktive për sa i përket rekrutimit të studentëve në programet e ciklit të parë drejtpërsëdrejti nga shkollat e mesme shqiptare. Universiteti organizon ditë të hapura dhe merr pjesë në panairin e përvitshëm për studentët, që organizohet nga Ministria. Studentët e kanë vlerësuar pozitivisht informacionin e dhënë për programet e mundshme të studimit, të cilat gjenden në faqen e internetit të Universitetit. UAMD-ja ka një Degë proaktive dhe të efektshme për Këshillimin e Studentëve dhe Alumnit, që ka një rol kyç për sa i përket dhënies së ndihmës në veprimtaritë e orientimit për studentët e rinj. Në mënyrë që të mbështetet procesi i tutorimit në të gjithë Universitetin, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit po zhvillon një projekt për të shqyrtuar se sa i efektshëm është sistemi aktual. UAMD-ja siguron nivele të përshtatshme mbështetjeje për kategoritë e veçanta sociale. UAMD-ja nxit dhe mbështet pjesëmarrjen e studentëve në jetën Universitare. Studentët kanë Këshillin e Studentëve ku mund të diskutojnë për çështje të ndryshme dhe të ngrenë probleme, të cilat përfaqësohen studentorë ua paraqesin Këshillave të Fakultetit dhe Senatit Akademik për zgjidhje. Punësimi i të diplomuarve ka rëndësi të veçantë për universitetin, ndaj UAMD-ja ka vënë në zbatim procese të efektshme për t'iu ardhur në ndihmë studentëve që të punësohen dhe që të bëjnë praktikën gjatë vitit të tretë të programeve të tyre të ciklit të parë.

Pasi arriti në këto gjykime, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përcaktoi pesë fusha të praktikave të mira, të cilat universiteti mund t'i përmirësojë dhe t'i përhapë në të gjithë sektorin e arsimit të lartë në Shqipëri. Gjithashtu, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka identifikuar një fushë, në të cilën universiteti ka pranuar se nevojiten zhvillime të mëtejshme dhe ka konfirmuar veprimin e propozuar nga universiteti. Së fundi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i bërë rekomandim universitetit, që të marrë në konsideratë sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tij dhe përmirësimin e mëtejshëm të përvojave të mësimnxënies për studentët e tij.

Universiteti e ndërmori vetëvlerësimin në përputhje me udhëzimet e APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm verifikon nivelin e angazhimit të universitetit në proces dhe bashkëpunimin e tij me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga z. Grant Horsburgh (Kryetar), Prof. Jeremy Bradshaw, Prof. Sherif Bundo, Dr. Alketa Grepcka, Stephen Harris dhe Prof. Jethro Newton (Anëtarë).

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se Standardet e Cilësisë janë përmbushur plotësisht në katër Fusha Vlerësimi dhe kryesisht në një Fushë Vlerësimi dhe, që në përgjithësi, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi praktikat e mira me karakteristikat e mëposhtme:

- puna e Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit dhe proceset e përdorura për gjurmimin e vendeve ku janë punësuar të diplomuarit, me anketime të rregullta dhe shumë forma të tjera të komunikimit me punëdhënës dhe partnerë të tjerë vendor dhe rajonal (pika 1.11)
- mundësitë e ofruara për studentët e Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën për përvoja të praktikës profesionale, stazhit dhe mundësitë e punësimit (pika 1.12)
- niveli i integritimit dhe i përkushtimit i zhvilluar në bashkëpunim me komunitetin vendor (pika 2.4)
- biblioteka është pjesë e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike të Shqipërisë dhe kjo u mundëson personelit dhe studentëve që të kenë akses në më shumë libra, qofshin në format të shtypur apo në internet (pika 2.11)
- ofrimi i orareve dhe i informacioneve për syllabusin në internet (pika 3.8)
- shkalla e lartë e përkushtimit të universitetit me organet e jashtme për zhvillimin e kurrikulës, ofrimin e praktikave dhe praktikave profesionale dhe të mundësive të punësimit për të diplomuarit e tij (pika 3.12)

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e mekanizmave për informimin e autoriteteve drejtuese dhe studentëve për propozimet, opinionet dhe vendimet e Rektoratit dhe Senatit Akademik (pika 1.2)

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- veprime të ndërmarra nga Rektorati ose Senati Akademik, lidhur me raportet institucionale dhe të dhënat e hartuara me qëllim sigurimin e cilësisë, monitorimin, dhe përmirësimin t'iu komunikohen qartë komunitetit të gjerë akademik, dhe përdorimi i feedback-ut të studentëve nga anketimet e vlerësimit të përforcohet duke vënë në zbatim mekanizma në nivel universiteti, fakulteti dhe departamenti për informimin e studentëve për veprimet e ndërmarra për t'iu dhënë një përgjigje shqetësimeve të tyre dhe feedback-ut që ata japin (pika 1.2).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- punë e filluar në përputhje me Statutin e UAMD-së, rregulloren e brendshme, dhe strukturën organizative, për të trajtuar kërkesat e ligjit të ri për arsimin e lartë (pika 1.1).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.
2. Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.
3. Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Gjykim i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Këshillit të Akreditimit se në Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Raporti i vetëvlerësimit [RVV fq.. 5-7] jep një përmbledhje të qeverisjes së universitetit dhe kuadrot e tij rregullatore, që janë hartuar në përputhje me dispozitat e legjislationit kombëtar për institucionet e arsimit të lartë. UAMD operon në përputhje me kërkesat e Statutit të tij (2011) dhe me Rregulloren e Brendshme (2012). [RVV Dok. 1, 2 & 10; Dok. sqarues fq. 2-3; Mbledhjet 1-3; 8, 9 & 12]. Statuti i UAMD-së është në përputhje me misionin institucional, dhe shqyrtohet dhe ndryshohet sipas faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm. Universiteti ka filluar të paraqesë ndryshime, që të mundësojë përputhjen me kërkesat e ligjit të ri dhe me aktet nënligjore përkatëse, kur ato të miratohen. Kështu, **pohohet** se ka filluar puna me Statutin e UAMD-së, rregulloren e brendshme, dhe strukturën organizative, për të trajtuar kërkesat e ligjit të ri për arsimin e lartë. [Kapitulli III, , Standardi I.1]

1.2 UAMD-ja është organizuar për të siguruar menaxhim të efektshëm dhe marrëveshjet ekzistuese dhe të ardhshme për drejtimin dhe administrimin e universitetit, dhe për vendimmarrjen kolegjiale, zbatohen në mënyrë të përshtatshme dhe kuptohen nga personeli në të gjitha nivelet. [RVV fq.. 7-8; RVV Dok. 9 & 10; Dok. sqarues fq.4-5(6);fq.5(7) & fq.5(8); Dok. e vizitës 1 & 15; Informacion shtesë 18; Mbledhjet 3-6, 9-10 & 12] Në përgjigje të ligjit të ri për arsimin e lartë, po zbatohen ndryshime në struktura dhe pozicione organizative. Për shembull, janë emëruar persona të rinj në nivel Rektorati dhe në pozicionet e punës për drejtimin e fakultetit. [Dok. sqarues fq.9(21)] Këshilli i Administrimit është zëvendësuar nga një Bord i ri Administrimi, dhe Këshilli i Profesorëve është zëvendësuar nga një Këshill i Përhershëm për titujt akademikë. [Dok. i vizitës 5] Megjithatë, universiteti nuk i përdor në mënyrë të efektshme raportet dhe të dhënat për çështjet e cilësisë, dhe informacionet dhe feedback-un e marrë nga anketimet e studentëve. Po ashtu, nuk ekzistojnë mekanizma formalë që të pajisin komunitetin e gjerë akademik me feedback për veprimet e ndërmarra nga Rektorati ose Senati Akademik, që vijnë si rezultat i analizimit të të dhënave të raporteve dhe anketimeve. Gjithashtu, universiteti, fakultetet dhe departamentet nuk i njoftojnë studentët për veprimet e ndërmarra si përgjigje ndaj feedback-ut të tyre. [RVV Dok. 5-6 & 53-56; Dok. i vizitës 14; Informacion shtesë 5, 6 & 9; Mbledhjet 1, 2 & 4-6] Për rrjedhojë, mungesa e mekanizmave për informimin e autoriteteve drejtuese dhe të studentëve lidhur me propozimet, opinionet dhe vendimet e Rektoratit dhe Senatit Akademik konsiderohet si **dobësi**. [Kapitulli III, Standardi II. 3] Rekomandohet që veprime të ndërmarra nga Rektorati dhe Senati Akademik, lidhur me raportet institucionale dhe të dhënat që synojnë sigurimin e cilësisë, monitorimin, dhe përmirësimin, t'iu komunikohen qartë komunitetit të gjerë akademik dhe përdorimi i feedback-ut të studentëve nga anketimet e vlerësimit të përforcohet duke vënë në zbatim mekanizma në nivel universiteti, fakulteti dhe departamenti për informimin e studentëve për veprimet e ndërmarra për t'iu dhënë një përgjigje shqetësimeve të tyre dhe feedback-ut që ata japin. [Kapitulli III, , Standardi I.2]

1.3. UAMD mbështet diskutimet dhe debatet në organet e tij kolegjiale. Bordet dhe këshillat e Universitetit mblidhen rregullisht dhe informacionet për pikat e axhendës mundësohet paraprakisht. Organizimi i funksionimit të këshillave dhe bordeve vendimmarrëse, dhe për mbështetjen e diskutimeve dhe debateve kolegjiale, kuptohen nga personeli dhe studentët. Anëtarët e Rektoratit dhe drejtuesit e lartë në shkallë fakulteti dhe departamenti janë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të vendimeve.[RVV pp8-9 & 41; Dok. sqarues fq.5(8) & p19(4); Dok. i vizitës 6; Informacion shtesë 17; Mbledhjet 2, 3, 5-6 & 9-11] [Kapitulli III, Standardi I.3]

1.4. UAMD sigurohet që kufijtë e autonomisë së tij të respektohen dhe që ai ta ushtrojë autonominë e tij brenda kufijve të legjislativorit dhe rregulloreve në fuqi. Vetëqeverisja në marrëdhëniet institucionale përfshin të gjitha njësitë organizative akademike dhe administrative, veprimtaritë e mësimdhënies dhe shkencore, çështjet financiare dhe administrative, dhe miratimin e marrëveshjeve institucionale me organe të jashtme. UAMD-ja ka kërkuar mundësi financimi të jashtëm dhe ka përfituar nga programe dhe projekte Evropiane. **[RVV fq. 9-10; RVV dok. 23 & 58; Dok. sqarues fq.. 5-6(10) & fq.. 6 (11 & 120); Mbledhjet 3-4, 8 & 10]** Auditit dhe kontrolli i brendshëm i kryer nga njësi e pavarur e brendshme e auditit në Rektorat, në mënyrë të efektshme siguron që UAMD-ja është në përputhje me Statutin institucional, rregulloren e brendshme dhe me ligjin kombëtar të arsimit të lartë. Me anë të marrëveshjeve të nënshkruara, ekspertët e jashtëm i japin Rektoratit këshilla të pavarura për çështjet e autonomisë dhe të llogaridhënies. **[RVV fq. 10] [Kapitulli III ,Standardi I.4]**

1.5. Është e këshillueshme që personeli të ndërgjegjësohet lidhur me procesin dhe dokumentet e planifikimit të UAMD-së. Ekzistojnë mundësi për diskutim dhe përfshirje në fazën e ndryshme, si në organet e drejtimit ashtu edhe në këshillat vendimmarrëse. **[RVV fq. 10 & 41; RVV dok. 8; Dok. sqarues fq.5(9); Info. shtesë 16; Mbledhjet 1, 3 & 9-10]** Strategjia institucionale për periudhën 2010-2016 ishte përpiluar në përputhje me misionin, vizionin dhe qëllimin e UAMD-së. Strategjia përmban një analizë SWOT dhe ka identifikuar qëllimet dhe objektivat, matjen e performancës, synimet dhe planin e veprimit. **[Info. shtesë 16]** Si pasojë e ndryshimeve të jashtme ligjore dhe ndryshimeve të tjera, plani strategjik aktual po zëvendësohet nga një plan i ri dhe kanë nisur bisedimet e para. **[RVV fq. 10] [Kapitulli III,Standardi I.5]**

1.6 Raporti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (Ministria) ofron shpjegime për programet e mësimdhënies dhe studimit, kërkimin shkencor, personelin, veprimtarinë në kuadrin e projekteve dhe çështjeve ekonomike e financiare. Në përputhje me Statutin e UAMD-së, ky raport është i disponueshëm në faqen e internetit të Universitetit; procesi është i efektshëm dhe personeli i kupton marrëveshjet. **[RVV fq.10; REV Dok. 1 & 5; Dok. sqarues fq.19(6); Mbledhjet 5 & 9-10]** Rektorati iu kërkon departamenteve dhe personave përgjegjës për programet e studimit të hartojnë raporte vetëvlerësimi për mësimdhënien dhe veprimtaritë kërkimore, kështu, procesi i hartimit të strategjisë merr informacion nga raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të vetëvlerësimit për veprimtaritë e departamentit dhe të programeve të studimit. **[REV Dok. 45; Info. shtesë 13; Mbledhjet 9-10]** Rektori organizon një mbledhje të hapur me Senatit Akademik dhe Këshillin e Administrimit, ku ftohen i gjithë personeli dhe studentët, për të diskutuar rreth raportit përpara miratimit nga organet qeverisëse të Universitetit dhe dërgimit në Ministrinë. **[Mbledhjet 3 & 9-10] [Kapitulli III, Standardi I.6]**

1.7 Veprimtaritë akademike dhe shkencore të UAMD-së ndërmerren në gjashtë fakultete dhe 23 departamente, apo njësi bazë. **[RVV fq.. 11; RVV Dok. 1-2; Dok. sqarues fq.-6(10); Mbledhjet2, 4 & 10-11]** Gjithashtu, Qendra për Zhvillim dhe Ekselencë mbështet veprimtaritë kërkimore, ndërsa Qendra për Edukimin në Vazhdim ofron shërbimet e formimit dhe përditësimit për mësuesit. **[REV fq.. 11]** Fakultetet dhe departamentet janë të organizuara në përputhje me dispozitat ligjore, dhe strukturat drejtuese, ekzekutive, dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike dhe njësitë organizative dhe stafi akademik i njësi bazë është i kualifikuar. **[Mbledhjet 2-3]** UAMD-ja ka liri akademike për sa i përket mësimdhënies dhe kërkimit, po ashtu edhe lidhur me administrimin organizativ dhe autonominë financiare. Stafi akademik ka pavarësi, për sa i përket organizimit të veprimtarive akademike në mësimdhënie, punë kërkimore, dhe në kurrikulën e programeve të studimit. **[RVV Dok. 49-51; Dok. i vizitës 2; Mbledhja 10]** Strukturat janë të qarta dhe funksionojnë në mënyrë të efektshme. **[Mbledhjet 1, 3, 4 & 9-10] [Kapitulli III, Standardi II.1]**

1.8 UAMD-ja ofron programe në tre cikle studimi. Studimet e ciklit të dytë ofrohen në të gjitha fakultetet përveç Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën, ndërsa studimet e doktoratës ofrohen në Fakultetin e Biznesit. **[RVV fq.11]** Megjithatë, siç e ka nënvizuar edhe universiteti, nevojiten përmirësime në fushën e kërkimeve të zbatuara për doktoratë dhe duhet të përforcohet dhe të zgjerohet niveli i kërkimeve shkencore të zbatuara të lidhura me tregun, që janë ndërmarrë nga doktorantët. **[REV fq. 11-12; Mbledhjet 2, 3 &10]**
[Kapitulli III, Standardi II.1]

1.9 Përfshirja e personelit në bordet dhe këshillat e ngritur institucionale bëhet në shkallë të përshtatshme. Ka vend për diskutime dhe debate dhe për përfshirjen në vendimmarrje. Gjithashtu, personeli është i informuar për marrëveshjet e reja dhe të ardhshme. **[RVV fq.41; Dok. sqarues fq. 19(4); Mbledhjet 2, 3 & 10]** Për më tepër, studentët kanë mundësi të përfshihen në proceset e administrimit dhe këshillat vendimmarrëse. **[REV Dok. 16-18; Mbledhjet 5-6] [Kapitulli III, Standardi II.3]**

1.10 Lidhur me punësueshmërinë, pranimin në universitet, pagesën e tarifës shkollore, dhe përdorimin e informacioneve publike, arrihet në përfundimin se UAMD-ja respekton dhe funksionon në përputhje me rregullat aktuale të konkurrencës. **[RVV Dok. 1-2; Mbledhjet 4 & 8]** UAMD-ja përditësohet rregullisht për zhvillimet ekonomike në rajon. **[RVV fq. 12]** Gjithashtu, Plani i Zhvillimit Strategjik thekson rëndësinë e trajtimit të kërkesave të tregut të punës. **[RVV Dok. 8]** Disa nga veprimtaritë mbështetëse përfshijnë studimet e ndërmarrja nga disa prej fakulteteve, si ato të ndërmarrja nga Fakulteti i Biznesit për punësimin e të diplomuarve, dhe studimin e tregut për nevojat e punësimin të kryer nga Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën. **[Dok. sqarues 9(20)]** Megjithatë, Universiteti pohon se jo të gjitha fakultetet janë mjaftueshëm aktive lidhur me studimet e tregut të punës dhe thekson se kjo çështje ka nevojë për përmirësim. **[REV fq. 41] [Kapitulli III, Standardi III.1]**

1.11 Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit iu ofron studentëve këshilla punësimi, informacione për mundësitë e punësimin dhe kryen monitorime të vazhdueshme e gjurmon punësimin e të diplomuarve. **[Dok. sqarues fq. 8(18-19) & fq. 17(1); Dok. e vizitës; Ndjekja e vendeve ku janë punësuar të diplomuarit; Mbledhjet 2, 3 & 9]** Zyra punon ngushtësisht me të diplomuarit në mbledhjen e informacioneve për karrierat dhe punësueshmërinë e tyre. **[RVV Dok. 68; Dok. shtesë 1.18]** Gjithashtu, zyra bashkëpunon me shumë punëdhënës për të bërë koordinimin ndërmjet studentëve dhe mundësive të punësimin, dhe për të organizuar aktivitete rekrutimi. **[Dok. shtesë 1.19]** Studentët, të diplomuarit dhe punonjësit e vlerësojnë punën e Degës së Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit dhe proceset e përdorura për ndjekjen e vendeve ku janë punësuar të diplomuarit, si anketimet e rregullta dhe shumë forma të tjera të komunikimit me punëdhënës dhe partnerë të tjerë vendor dhe rajonal, që përfaqësojnë praktikë të mirë. **[Kapitulli III, , Standardi III.1]**

1.12 UAMD-ja bashkëpunon me sukses me një sërë organizatash qeveritare dhe jofitimprurëse, shpesh me anë të marrëveshjeve formale. **[RVV fq.13; Dok. Sqarues fq. 9(22); Mbledhjet 3-7 & 10]** Megjithëse universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, nuk ka regjistër qendror. **[RVV Dok. 15, 23 & 58; Dok. sqarues fq. 10(23) & fq. 19(8); Mbledhjet 9-10]** Një pjesë e mirë e hartimit dhe zhvillimit të programeve të reja të studimit, dhe ndryshimet e bëra tek ato ekzistuese vijnë si rrjedhojë e marrëdhënieve dhe partneriteteve të bashkëpunimit. **[RVV fq. 14 & 41; Dok. sqarues fq. 11(2)]** Të tilla marrëveshje sjellin përfitime për studentët (përmes lidhjeve në tregun e punës), për programet studentore (përmes ndikimit të punëdhënësit), dhe për stafin (përmes lidhjeve për kërkimet dhe mundësive për mobilitet ndërkombëtar). **[RVV fq. 14; Dok. sqarues fq. 9(19), fq. 14-15(2) & fq. 16(6); Dok. i vizitës 11.3; Mbledhjet 3-5 & 9-10]** Mundësitë e disponueshme për studentët e Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën për të pasur akses në përvojat e praktikës profesionale, në stazhe dhe mundësi punësimi janë shembuj të praktikave të mira. **[Kapitulli III, , Standardi III.2]**

1.13 Shtytysa kryesore e bashkëpunimit të UAMD-së me institucione të jashtme është ofrimi i mundësive të studimeve praktike. **[SED p14; Dok. sqarues fq. 14-15(2), fq. 16(6) & fq. 7(15); Mbledhjet 12]** Mbledhjet me studentët dhe partnerët e jashtëm konfirmuan se studentët mund të përfitojnë nga të tilla lidhje me punëdhënës publik dhe privat, qofshin këta vendor apo rajonal, dhe që këto organizata i ofrojnë mundësi studentëve për të përfituar nga mundësi për studime praktike. **[Dok. i vizitës 11.3; Mbledhjet 5-7]** Për shembull, Fakulteti i Studimeve Profesionale është i angazhuar në një nismë të suksesshme ndërkombëtare, ku bashkëpunon me një organizatë zvicerane dhe me Ministrinë për të hartuar dhe ofruar programe studimi profesionale në informatikë. Megjithatë, numri më i madh i marrëveshjeve të bashkëpunimit për mundësitë e studimeve praktike janë të nënshkruara nga vetëm dy fakultete (Fakulteti i Edukimit dhe Fakulteti i Studimeve Profesionale). **[RVV fq. 14 & 41; Mbledhjet 4 & 9-10]** Universiteti pohon se duhen bërë përmirësime dhe që të tilla standarde duhet të vendosen në të gjitha fakultetet. **[Kapitulli III, , Standardi III.3]**

1.14 UAMD-ja pohon dëshirën për të rritur nivelin e mobilitetit ndërkombëtar të personelit dhe të studentëve, duke nxitur aplikimet nga të gjitha fakultetet. **[RVV fq. 41]** Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve ofron këshilla dhe mbështetje për projektet e financuara nga BE-ja në kuadrin e marrëveshjeve për Erasmus+ dhe Tempus, dhe për marrëveshjet e mobilitetit për stafin dhe studentët nën Erasmus + dhe skema të tjera, si për shembull, veprimtari formimi afatshkurtra. Gjithashtu, Universiteti nxit angazhimin e herëpashershëm të ekspertëve të huaj. **[RVV fq. 14-15 & fq. 41; RVV Dok. 13, 15, 20, 23, 25-26, 45 & 58; Dok. sqarues fq. 11(2); Dok. e vizitës 9 & 13.2]** Megjithatë, volumi aktual i veprimtarisë ndërkombëtare në punën me projekte dhe mobilitet është modest. **[REV fq. 41; Mbledhjet 3-4]** **[Kapitulli III, Standardi III.4]**

Gjetjet

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë.

- puna e Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit dhe proceset e përdorura për gjurmimin e punësimit të të diplomuarve, si anketimet e rregullta dhe shumë forma të tjera të komunikimit me punëdhënës dhe partnerë të tjerë vendor dhe rajonal (pika 1.11)
- mundësitë e disponueshme për studentët e Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën për akses në përvoja të praktikës profesionale, stazh dhe mundësitë e punësimit (pika 1.12).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e mekanizmave për informimin e autoriteteve drejtuese dhe studentëve për propozimet, opinionet dhe vendimet e Rektoratit dhe Senatit Akademik (pika 1.2)

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- ndërmarrjen e veprimeve nga Rektori ose Senati Akademik që raportet institucionale dhe të dhënat me qëllim sigurimin e cilësisë, monitorimin, dhe përmirësimin t'iu komunikohen qartë komunitetit të gjerë akademik, dhe të përforcohet përdorimi i feedback-ut të studentëve nga anketimet e vlerësimit duke vënë në zbatim mekanizma në nivel universiteti, fakulteti dhe departamenti për informimin e studentëve për veprimet që janë ndërmarrë për t'iu dhënë përgjigje shqetësimeve të tyre dhe feedback-ut që ata japin (pika 1.2).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- punë e filluar në përputhje me Statutin e UAMD-së, rregulloren e brendshme, dhe strukturën organizative, për të trajtuar kërkesat e ligjit të ri për arsimin e lartë (pika 1.1).

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 UAMD-ja ka një organigramë të qartë, të shpallur në faqen e internetit të Universitetit dhe që përshkruan përgjegjësitë për administrimin e burimeve njerëzore. **[RVV Dok. 1.9]** Politika e universitetit për rekrutimin dhe punësimin e stafit akademik dhe personelit administrativ bëhet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të universitetit dhe me legjislacionin shqiptar. **[RVV fq. 16; RVV Dok. 1.1, 1.2, 1.16 & 1.17; Mbledhjet 3 & 5]** Gjatë rekrutimit në pozicione mësimdhënieje, jepet vlerësim shtesë për përvojën dhe kualifikimet e fituara në universitete amerikane ose evropiane. **[RVV Dok 1.18]** Politika dhe procedurat e universitetit mbështesin në mënyrë të efektshme dhe orientojnë punësimin me kohë të plotë dhe të pjesshme të një personeli të kualifikuar, që përmbush kërkesat akademike dhe administrative të universitetit. **[Kapitulli III, Standardi IV.1]**

2.2 Në përputhje me Planin e Zhvillimit Strategjik 2010-2016, UAMD-ja përcakton se një rëndësi të veçantë ka krijimi i një ndjenje të komunitetit midis personelit dhe studentëve, që mund të arrihet përmes përfshirjes, mbështetjes dhe kolegjalitetit në qasjet e zgjedhura. **[RVV dok. 1.8]** Kjo përfshin ofrimin e formimeve, tryezave të punës dhe aktiviteteve kulturore për stafin akademik dhe personelin administrativ, dhe përfshin edhe mbështetjen e grupeve të stafit akademik në organizimin e konferencave ndërkombëtare dhe rajonale dhe veprimtari tjera në universitet. **[SED fq. 17; SED dok. 1.21, 1.22, 3.9 & 3.10]** Për shembull, përmes një projekti Tempus, me temën: “Si të krijohen burime novatore në mësimdhënie”, tetë profesorë u formuan në universitete amerikane dhe evropiane, dhe pasi u kthyen, organizuan tryeza pune me pjesën tjetër të personelit, në mënyrë që të ndanin përvojat e tyre me ta. Universiteti organizon një ditë informimi, gjatë së cilës zhvillohen seminare dhe tryeza pune, ku janë të ftuar i gjithë personeli dhe studentët. **[Mbledhja 5]** Me ndihmën e DURSAK, një organizatë që përfaqëson qytetarët e Durrësit, UAMD-ja, në bashkëpunim me komunitetin vendor, organizon aktivitete kulturore për personelin dhe studentët. **[RVV dok. 3.4] [Kapitulli III, Standardi IV.2]**

2.3 UAMD-ja ka mekanizma të brendshëm për vlerësimin e personelit akademik dhe secili departament është përgjegjës për administrimin e procesit. Në fillim të çdo viti akademik, stafit akademik i jepen detyrat përkatëse dhe nënshkruhet një marrëveshje formale ndërmjet përgjegjësit të departamentit dhe secilit anëtar të stafit akademik. Plani paraqet planin akademik për programet e tyre të studimit, çfarë do të shpjegojnë, çfarë kanë në plan të botojnë, dhe veprimtari të tjera akademike. Në fund të vitit, përgjegjësi i departamentit zhvillon një mbledhje me anëtarët e stafit akademik për të përcaktuar se sa i efektshëm ka qenë plani i tyre. **[RVV fq. 17; RVV dok. 1.54 & 1.55; Mbledhja 2]** Cilësia e mësimdhënies vlerësohet çdo dy vjet me anë të anketimeve të studentëve, që hartohen dhe administrohen nga Zyra e Cilësisë. Megjithatë, rezultati i këtyre anketimeve jepet si një përqindje e vetme për çdo pedagog dhe prandaj nuk mund të përdoret për të identifikuar plotësisht nevojat për zhvillim. **[RVV Dok 1.53, 1.56, 2.4 & 5.2; Pikëzimet për vlerësimin e studentit; Mbledhja 2]** Gjithashtu, UAMD-ja beson se mekanizmat e brendshme për vlerësimin e stafit akademik janë instrumente që nxisin rritjen profesionale. **[RVV fq. 17]** Megjithatë, ekzistojnë metoda të ndryshme për vlerësimin formal të mësimdhënies në universitet, që më shumë përqendrohen në identifikimin e problemeve, se sa në pikëpamjen e zhvillimit profesional. **[REV dok. 1.62 & 3.14; Mbledhjet 8-9] [Kapitulli III, Standardi IV.3]**

2.4 UAMD-ja ka një politikë zhvillimi të qëndrueshëm dhe të efektshëm shoqëror dhe në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Durrës, po ndërmerr disa nisma mjedisore. **[RVV fq. 18]** Për shembull, gjatë një diskutimi me një grup partnerësh të jashtëm, shumë nga të cilët janë alumni të universitetit, u theksua se shumica e organizatave të tyre iu ofrojnë studentëve të universitetit mundësi për stazh dhe praktikë profesionale, ku në disa raste ndodh që studentët të punësohen me kohë të plotë. **[Mbledhja 7]** Dega e Alumni bashkërendon

veprimtaritë midis studentëve dhe organizatave të jashtme. **[RVV Dok. 1.67, 1.68 & 3.11.3]** Partnerët e jashtëm u shprehën se janë të përfshirë drejtpërdrejtë me fakultetet në zhvillimin e kurrikulave. Për shembull, Fakulteti i Drejtësisë ka marrëveshje me avokatët dhe gjykatat vendore dhe ka komunikime formale dhe joformale me zyrtarët e tyre lidhur me kurrikulën. Gjithashtu, kreu i një strukture të Këshillit Vendor u shpreh se struktura e saj i ka dhënë universitetit të dhëna për kërkimet dhe se kërkimet vijuese nga universiteti e kanë ndihmuar shumë strukturën në punën e vet. **[RVV Dok. 1.29 & 3.4; Mbledhjet 3 & 7]** Partnerët e jashtëm që punojnë me institucione të tjera të arsimit të lartë u shprehën se shkalla e integritit dhe e angazhimit që ka zhvilluar UAMD-ja me komunitetin vendor është një karakteristikë e **praktikës së mirë. [Kapitulli III, , Standardi IV.4]**

2.5 UAMD-ja përcakton qartë të gjitha detyrat lidhur me administrimin e burimeve njerëzore. Funkcionet janë përcaktuar në Statut, në Rregulloret e fakulteteve dhe në ato që kanë të bëjnë me departamentet dhe grupet kërkimore. **[Kapitulli III, , Standardi II.2]**

2.6 UAMD-ja ka procedurë transparente dhe të përshtatshme për menaxhimin e burimeve financiare, që janë parashikuar dhe administruar në përputhje me standardet dhe rregulloret e menaxhimit të financave publike, dhe pasqyrat përkatëse i dërgohen Ministrisë çdo vit. **[RVV Dok. 1.1, 1.2 & 1.27]** Buxheti për universitetin hartohet në përputhje me ligjin për arsimin e lartë. Procesi i hartimit të buxhetit drejtohet nga grupet e administrimit dhe ata të programeve të buxhetimit, që diskutojnë buxhetet individuale me departamentet dhe që punojnë nën drejtimin e Rektoratit. Pasi hartohet, buxheti diskutohet nga Këshilli i Administrimit dhe i dërgohet te Senati Akademik për miratim. **[RVV fq. 19; RVV Dok. 1.5 & 2.2; Dok. i vizitës 6 Raporti Vjetor Financiar]** Stafi akademik dhe personeli administrativ i dinë detyrat e tyre për procesin e hartimit të buxhetit vjetor. **[Mbledhjet 2-4 & 8-9] [Kapitulli III, Standardi VI.1]**

2.7 Në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e Brendshme të universitetit **[RVV Dok. 1.1 & 1.2]** Këshilli i Administrimit është organi vendimmarrës i universitetit që mbikëqyr dhe kontrollon drejtimin administrativ, financiar dhe ekonomik të aseteve dhe pronave të universitetit. Kancelari kryeson Këshillin Administrativ dhe është përgjegjës për zbatimin e politikave financiare dhe për administrimin e përditshëm dhe menaxhimin financiar të universitetit. **[RVV fq. 19; Mbledhje 4]** Departamenti i Menaxhimit Financiar dhe Departamenti i Shërbimeve, Investimeve dhe Prokurimeve e ndihmojnë Kancelarin në zbatimin dhe kontrollin e buxhetit. **[RVV fq. 19; RVV Dok. 1.27 & 2.2; Mbledhjet 3-4]** **[Kapitulli III, Standardi VI.2]** UAMD-ja i nënshtrohet proceseve të auditit të brendshëm, të jashtëm, nga Kontrolli i lartë i Shtetit dhe nga Ministria. Proceset e auditit janë të përcaktuara qartë në legjislacion. **[Kapitulli III, , Standardi VI.3]**

2.8 Sistemi i Informacionit i UAMD-së është i organizuar në formën e bazës së të dhënave, me faqe të aksesueshme nga faqja e universitetit. Me anë të kësaj faqeje interneti zhvillohen komunikimet akademike dhe ato midis personelit të brendshëm. Të gjithë studentët dhe stafi akademik dhe personeli administrativ kanë adresat e tyre individuale të emailit të universitetit. **[RVV fq. 20; Mbledhjet 5-6 & 8-9]** Kancelari është përgjegjës për shkëmbimin e informacionit brenda universitetit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe më Zyrën e Regjistrimeve dhe Regjistrave. **[RVV fq. 20, RVV Dok. 1.30]** Në një seksion të faqes së internetit, që administrohet nga Zyra për Këshillimin e Studentëve dhe Alumnit, paraqiten informacione statistikore mbi numrin e studentëve dhe programet e tyre të studimit. Megjithëse UAMD-ja nuk ka një ambient virtual mësimnxënies, komunikimi ndërmjet stafit dhe studentëve mbështetet në mënyrë të efektshme nga sistemi i informacionit. **[Kapitulli III, , Standardi VII.1]** Infrastruktura e teknologjisë së informacionit në UAMD përfshin kompjuterë, laboratorë kompjuteri, fotokopje, printera, skanerë, projektorë, programe të përgjithshme dhe të specializuara, si dhe internet të shpejtë me bandë të gjerë dhe Wi-Fi. **[RVV fq. 21; Mbledhjet 5-6]** Këshilli i Administrimit në bashkëpunim me Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit bashkërendojnë veprimtaritë e

teknologjisë së informacionit të universitetit. Personeli dhe studentët janë shprehur se janë të kënaqur me lehtësirat e teknologjisë së informacionit që i janë vënë në dispozicion. Studentët kanë konfirmuar se materialet mësimore janë të disponueshme në internet ose pedagogët ua dërgojnë me email. Gjithashtu, në të njëjtën mënyrë informohen edhe për notat. Biblioteka ofron formim falas një herë në javë për studentët në fushën e njohurive digjitale. **[Mbledhjet 4-6 & 8-9] [Kapitulli III, Standardi VII.2]**

2.10 AMU ka tre godina kryesore: kampusi origjinal në Currila, Durrës; një godinë tjetër në Durrës, e cila është marrë me qira dhe përdoret nga Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën, nga Departamenti i Inxhinierisë dhe Departamenti i Mekanikës dhe Transportit; dhe një kampus i ri, që ndodhet në Spitallë, në rrethinat e qytetit të Durrësit. **[RVV Dok. 1.31, 1.32]** Gjithashtu, universiteti ka ndërtuar një godinë të re në Spitallë, pranë Kampusit të ri, që po suvatohet dhe meremetohet, dhe që është përcaktuar të përdoret në fillimin e vitit akademik 2017-2018. **[RVV fq. 21; Turi i kampusit të ri; Mbledhja 2]** Universitetit i mbikëqyr projektet e ndërtimit dhe rikonstruksionit në përputhje me legjislacionin shqiptar. **[REV fq. 21; REV dok. 1.28] [Kapitulli III, Standardi VII.3]**

2.11 UAMD-ja ka një trashëgimi të pasur akademike dhe arkiva bibliotekare ruan trashëgiminë akademike, kulturore dhe shkencore të universitetit në përputhje me legjislacionin shqiptar. **[RVV fq. 21-22]** Në bibliotekë ruhen syllabuset dhe literatura përkatëse për të gjitha programet studimore dhe punimet e doktoraturës, botimet dhe tekstet e shkruara nga stafi akademik me kohë të plotë. **[RVV fq. 21]** Konferencat shkencore të organizuar nga universiteti i ofrojnë stafit akademik një mundësi për të paraqitur dhe promovuar punën e tyre. Këshilli i Publikimit i universitetit është një organ kolegjal i përbërë nga pesë anëtarë nga stafi akademik, që janë të miratuar nga Senati Akademik. **[RVV fq. 21; RVV Dok. 1.2]** Këshilli shqyrton, diskuton dhe miraton botimet e personelit akademik, që kanë të drejtë të bëjnë botime falas në Revistën Shkencore të Universitetit. Skedarët e të dhënave janë digjitalizuar dhe biblioteka ka afërsisht 8,000 libra në format të shtypur në shqip dhe gjuhë të tjera dhe 10,000 libra të tjerë janë në format elektronik. Gjithashtu, janë të aksesueshme edhe revistat në version elektronik. Gjithsej ka tre biblioteka, nga një në secilën godinë kryesore të Universitetit, dhe që të gjitha kanë mundësinë e kërkimit të materialeve që gjenden në biblioteka përmes internetit. Biblioteka është pjesë e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike të Shqipërisë dhe kjo i mundëson personelit dhe studentëve që të kenë akses në më shumë libra, qofshin në format të shtypur apo elektronik, karakteristike kjo e **praktikës së mirë**. **[REV fq. 22; Turi i burimeve; Mbledhjet 5-6 & 8-10] [Kapitulli III, Standardi VII.4]**

2.12 UAMD-ja ofron një infrastrukturë të përshtatshme për veprimtaritë akademike, administrative dhe shoqërore, përfshirë klasa, zyra, salla mbledhjesh, salla konferencash dhe auditorë, biblioteka dhe laboratorë ku mund të zhvillohen orët e mësimi, puna kërkimore dhe administrimi. **[RVV fq. 22; Mbledhja 4] [Kapitulli III, Standardi VII.5]** Sidoqoftë, studentët kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me paqëndrueshmërinë e lehtësirave të disponueshme në godina të ndryshme të universitetit. **[Dok. i anketimit të studentëve; Mbledhjet 5-6]** Për shembull, studentët e mirëpresin idenë e ndërtimit të konvikteve dhe të rikonstruksionit të mensave në godinën kryesore, të ngjashme me ato në godinën në Spitallë. Personeli mësimdhënës ka shprehur dëshirën për më shumë vijueshmëri në pajisjen e klasave me teknologji dhe pajisjen e laboratorëve në universitet. **[Turi i burimeve; Turi i kampusit të ri; Mbledhjet 5-6 & 8-10] [Kapitulli III, Standardi V.1]**

2.13 Aktualisht, universiteti nuk ka në plan të rrisë numrin e studentëve, por përkundrazi, ka në plan të përqendrohet në nivelin e studentëve që regjistrohen në universitet. **[Mbledhjet 1-2 & 4]** Sigurimi fizik i godinave dhe i personelit bëhet me anë të kontratave të shërbimit me shoqëri private të sigurimeve. Pronat e universitetit administrohen nga Departamenti i Menaxhimit Financiar në përputhje me legjislacionin shqiptar, ndërsa inspektimet për zjarre

dhe për higjienën ndërmerren nga autoritetet vendore përkatëse. **[RVV fq. 21; RVV Dok. 1.33, 1.34; Mbledhjet 3 -6 & 8-10] [Kapitulli III, Standardi VII.5]**

2.14 UAMD-ja ofron shërbime logjistike në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimet publike. **[RVV fq. 22]** Universiteti i vlerëson shërbimet logjistike që ofron përmes anketimeve periodike me personelin dhe studentët. Këto anketime kryhen në internet dhe administrohen nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. **[RVV dok. 1.35] [Kapitulli III ,Standardi VII.6]**

2.15 Arkivi i Protokollit është pjesë e bibliotekës dhe regjistron dhe ruan çdo dokument zyrtar të universitetit. **[RVV fq. 23]** Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit dhe Regjistrimeve i pajis studentët me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin për t'u regjistruar në portal, nga ku marrin oraret, informacione për programin dhe notat përmes adresës së emailit të vënë në dispozicion nga universiteti. Regjistrat e studentëve mbahen në format elektronik dhe të shtypur. **[Turi i resurseve; Mbledhjet 5-6 & 8-9] [Kapitulli III, Standardi V.2]**

Gjetjet

Praktikat e mira

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- niveli i integritimit dhe i përkushtimit i zhvilluar në bashkëpunim me komunitetin vendor (pika 2.4)
- Biblioteka është pjesë e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike të Shqipërisë dhe kjo u mundëson personelit dhe studentëve që të kenë akses në më shumë libra, qofshin në format të shtypur apo elektronik (pika 2.11).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk konfirmoi veprime aktualisht në proces lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Universiteti ka deklaruar se misioni i tij është "Krijimi, përvetësimi dhe ofrimi i një kontributi të vërtetë për njohuritë bazë, vlerat dhe komunitetin e Durrësit, për Shqipërinë dhe për rajonin, duke promovuar llogaridhënie të lartë, zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale". **[RVV Dok. 8]** Në përputhje me këtë mision, gjashtë fakultete që ofrojnë programe në të tre ciklet e studimit sipas Bolonjës. Programet e ciklit të tretë (Doktoraturë) ofrohen vetëm në Fakultetin e Biznesit për Shkenca Ekonomike. Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën ofron vetëm programe të ciklit të parë, përkatësisht tre programe studimi të integruara me praktikën në gjuhën angleze. **[RVV fq. 25; RVV dok. 39 ; Mbledhja 39]** **[Kapitulli I , Standardi I.1]**

3.2 Deri kohët e fundit, katër nga fakultetet ofronin programe të ciklit të parë me kohë të pjesshme, disa prej të cilave e zhvillojnë mësimin në fundjavë, në të mirën e studentëve që janë të punësuar ose nuk banojnë në Durrës. **[RVV fq. 25, RVV dok. 39]** Megjithatë, me ndryshimet e bëra në ligj në vitin 2014, u ndaluan programet me kohë të pjesshme, dhe nuk u pranuan aplikime të reja. **[Mbledhja 4]** Ndonëse ndryshimet më të fundit në ligjin e arsimit të lartë nënkuptojnë se programet me kohë të pjesshme mund të zhvillohen sërish, duhet që procesi i plotë i miratimit të zhvillohet në universitet dhe nga Ministria, por kjo nuk ka ndodhur ende. UAMD-ja ka shprehur synimin për të zhvilluar materiale të edukimit në vazhdim. **[RVV fq. 25]** Përveç disa veprimtarive të ndërmarra në kuadrin e projekteve Tempus, që mund të përshkruhen si kontribues për formimin dhe edukimin jashtë strukturës së diplomave formale **[RVV Dok. 23]** aktualisht Qendra për Edukimin në Vazhdim është e vetmja strukturë që ofron edukim në vazhdim në Fakultetin e Edukimit. **[RVV fq. 11; Mbledhjet 8-9 & 11]** Qendra për Edukimin në Vazhdim është e licencuar nga Ministria dhe ka filluar të zhvillojë kurrikula të reja në bashkëpunim me shkollat vendore. **[Mbledhja 11]** **[Kapitulli I , Standardi I.2]**

3.3 Shërbimet e ofruara nga UAMD-ja janë në përputhje me secilin prej tre cikleve sipas Bolonjës. **[RVV fq. 25; RVV Dok. 39; Mbledhja 9]** Objektivi e Strategjisë së zhvillimit të universitetit, është "Konsolidimi i kurrikulës në përputhje me standardet e Deklaratës së Bolonjës dhe me Sistemin Amerikan të Krediteve."**[RVV dokument 8]** Studentët kanë konfirmuar përdorimin e Sistemit Amerikan të Vlerësimit. **[Mbledhja 4-5]** **[Kapitulli I , Standardi I.3]**

3.4 Programet e studimit të UAMD-së ofrohen në përputhje me prirjet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Plani strategjik i Universitetit paraqet synimin e tij për të vazhduar punën me partnerët rajonalë, palët e interesit dhe bizneset, në mënyrë që të rrisin ndikimin e tyre në komunitetin vendor, të vazhdojnë të zhvillojnë partneritete kuptimplota në nivele vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të rrisë pjesëmarrjen e personelit në këto veprimtari. **[Dok. Shtesë 1.3]** **[Kapitulli I , Standardi I.4]**

3.5 UAMD-ja synon t'i bashkërendojë shërbimet që ofron me kërkesat e tregut të punës dhe me përparësitë dhe strategjitë vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. **[RVV fq. 26]** Studimi i tregut zakonisht ndërmerret nga departamenti përkatës dhe synon të identifikojë nevojat e tregut me qëllim hartimin e programeve të reja apo ndryshimin e atyre ekzistuese. Një lloj tjetër i studimit të tregut përqendrohet te punësimi i alumnit të UAMD-së me qëllim mundësimin e punësimit për studentët aktual. **[Dok shtesë 1.20; Mbledhjet 1 & 3]** Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën përdor një tjetër qasje, që ka sjellë ndryshime në Këshillin e Fakultetit, për të bërë të mundur që gjysma e anëtarëve të tij të zgjidhen nga organe të jashtme. Fakultetet e tjera kanë më pak anëtarë nga organet e jashtme, por bëjnë këshillime të shumta me organet e jashtme në Durrës dhe më gjerë. **[REV dok. 50; Mbledhjet 3 & 7; Dok. Shtesë 16]** **[Kapitulli I , Standardi I.4]**

3.6 Procesi i vlerësimit të programit dhe shqyrtimit të kurrikulës së UAMD-së zhvillohet në përputhje me Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë së universitetit. **[REV dok. 45 & 50-52] [Kapitulli I, Standardi I.4]**

3.7 Numri i studentëve në UAMD përcaktohet nga Ministria dhe në krahasim me kapacitetin institucional, numri i tyre ka qenë i lartë (1:37 raporti staf me kohë të plotë/studentë sipas 'Informacioneve rreth Institutit' dhe të dhënave të APAAL-it). Universiteti pranon se duhet të rrisë nivelin e studentëve që pranohen, dhe jo thjeshtë të rrisë numrin e studentëve. Gjithashtu, po e zgjeron ambientin e mësimnxënies me ndërtesa të reja dhe do të ndërtojë një kampus të ri në të ardhmen. **[Dok. shtesë 1.3; Mbledhjet 1-2, 4 & 8] [Kapitulli I, Standardi I.4]**

3.8 UAMD-ka ka një program orientimi për studentët e rinj, që përfshin kurrikulën dhe kurset e tyre, natyrën e vlerësimeve dhe penalteteve të tyre, bibliotekën dhe materialet mësimore, dhe ku të drejtohen për ndihmë dhe këshillim. **[RVV Dok. 24]** Gjithashtu, studentëve të rinj iu ofrohet mbështetje përmes një procesi këshillimi, që përfshin takime (pesë orë në javë) të studentëve me stafin akademik. **[RVV fq. 28; Mbledhjet 4-5]** Statuti i Universitetit i kërkon stafit akademik të paraqesë kopje të syllabusit gjatë orës së parë të mësimimit të çdo viti akademik. **[RVV Dok. 2 & 41; Dok. shtesë 3.2; Dok. i vizitës 14; Mbledhjet 4-5]** Ky informacion plotësohet nga një mjet në internet që pajis çdo student me oraret, notat, njoftime për veprimtari të ndryshme, dhe informacion rreth syllabusit. Nxënësit janë shprehur se oraret dhe informacionet për syllabusët që gjenden në internet janë të sakta dhe të dobishme. **[RVV fq. 37; Mbledhjet 4-5]** Një tjetër karakteristikë e praktikës së mirë është ofrimi i orareve dhe i informacioneve për syllabusin në internet. **[Kapitulli I, Standardi I.6, Kapitulli I Standardi I.8]**

3.9 Programet e studimit të ciklit të parë i pajisin studentët me njohuri bazë, me metodat dhe parimet shkencore, dhe shumë prej tyre përfshijnë mundësitë për kërkim dhe përvojë praktike, përfshirë praktikat profesionale me partnerë të jashtëm. **[Dok shtesë 3.3; Dok. i vizitës 1.6 & 14]** Në programet e ciklit të parë, Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën iu ofron studentëve një gamë të gjerë mundësish të jashtme për mësimnxënie. **[Mbledhja 3]** Në programet e ciklit të dytë përfshihen mundësitë për kërkim dhe përvojë praktike. **[Dok. shtesë 1.6; Dok. e vizitës 14]** Studentët kanë raportuar se i janë ofruar një sërë mundësish për të marrë pjesë në praktika dhe praktika profesionale dhe thanë se universiteti i mbështeste në mënyrë të përshtatshme. **[Mbledhja 4-5]** Lidhjet e ngushta të universitetit me alumnit dhe punëdhënësit bëjnë të mundur që të ketë mundësi të shumta për praktika profesionale dhe praktika. **[Dok. Shtesë 1.20 & 3.3; Dok. e vizitës 1.3 dhe 1.6; Mbledhjet 1, 3, 5 dhe 12] [Kapitulli I Standard I.7, Kapitulli I Standard I.9]**

3.10 Programet e studimit të ciklit të parë janë të organizuara në 15 javë me nga tre orë mësimi për lëndë, pa ndarje paraprake të ngarkesës javore ndërmjet mësimdhënies teorike dhe praktike. Megjithatë, kurrikula ka si qëllim të vendosë ekuilibër ndërmjet mësimdhënies teorike dhe praktike, dhe kjo është shprehur në syllabus. **[Dok. shtesë 1; Dok. i vizitës 3.3]** Në programet e ciklit të dytë, ka një raport 2:1 ndërmjet mësimdhënies teorike dhe praktike. **[Dok. shtesë 1; Dok. i vizitës 3.3; Mbledhja 5]** Lidhjet e shumta me organe të jashtme, përfshirë autoritetet kombëtare, dhomat e tregtisë, shoqëritë e sigurimeve, bankat, spitalet, edhe shoqëri të mëdha në Tiranë dhe Durrës iu ofrojnë studentëve mundësi të shumta për të fituar përvojë praktike në zbatimin e teorisë nëpërmjet praktikave dhe praktikave profesionale. **[RVV Dok. 8 & 13; Dok. shtesë 1.6; Mbledhja 8] [Kapitulli I Standardi I.11]**

3.11 Disa nga sfidat kryesore që identifikon Plani Strategjik i UAMD-së janë: cilësia e mësimdhënies dhe të nxënies; t'i shërbejë nevojave të vendit në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare; dhe të mësuarit nga kërkimet teorike dhe të aplikuar për procesin e të nxënies për t'u bashkërenduar me institucionet perëndimore. **[RVV Dok. 8]** Kriteri i testimit të gjuhës angleze për të gjithë studentët, është një shembull i ambicieve ndërkombëtare të

universitetit. Studentët janë të detyruar t'i nënshtrohen testimit të gjuhës angleze para se të mund të kalojnë në programet e ciklit të dytë apo të tretë. **[Dok shtesë 3.4]** Janë dhënë disa bursa Tempus dhe Erasmus + për mobilitetin e studentëve dhe të stafit. **[RVV Dok. 143-15; Mbledhja 3]** Universiteti pranon faktin se mobiliteti i studentëve është i kufizuar. **[RVV dok. 8; Dok. Shtesë 1.3] [Kapitulli I Standardi I.10]**

3.12 Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit iu ofron studentëve këshilla për punësim dhe informacione për mundësitë e punësimit. Ajo punon ngushtësisht me të diplomuarit për të mbledhur informacione për karrierat dhe punësueshmërinë e tyre. **[RVV Dok. 68; Dok. shtesë 1.18]** Zyra bashkëpunon me shumë punëdhënës për të bërë bashkërendimin midis studentëve dhe mundësive të punësimit, dhe për të organizuar aktivitete rekrutimi. **[Dok. shtesë 1.19]** Punësueshmëria është pjesë përbërëse e kurrikulës; shkrimi akademik është lëndë me detyrim për të gjithë studentët, dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit ofron formime me temë: "Si të shkruani CV (në gjuhën shqipe dhe angleze), si të shkruani një letër motivimi dhe si të silleni gjatë një interviste. **[Mbledhja 5]** Gjithashtu, studentët përfitojnë shumë mundësi për praktika dhe praktika profesionale falë lidhjeve të universitetit me alumnit dhe punëdhënësit. **[Dok. shtesë 1.3 & 1.6; Dok. i vizitës 1.20; Mbledhjet 1, 3, 5, 8 & 12]** Studentët, të diplomuarit dhe punonjësit e vlerësojnë shkallën e lartë të përkushtimit të universitetit me organet e jashtme për zhvillimin e kurrikulës, ofrimin e praktikave dhe praktikave profesionale dhe të mundësive të punësimit për të diplomuarit e tij, karakteristika këto të **praktikës së mirë**. Një shembull i kësaj qasjeje, por jo i vetmi, është ai i Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën **[Kapitulli I Standardi I.12]**

Gjetjet

Praktikat e mira

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- ofrimi i orareve në internet dhe i informacioneve për syllabusin (pika 3.8)
- shkalla e lartë e përkushtimit të universitetit me organet e jashtme për zhvillimin e kurrikulës, ofrimin e praktikave dhe praktikave profesionale dhe të mundësive të punësimit për të diplomuarit e tij (pika 3.12)

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk konfirmoi veprime aktualisht në proces lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 UAMD-ja ka mekanizmat e duhura për të siguruar organizimin dhe dokumentimin e programeve të studimit. **[RVV fq. 11-12; Mbledhjet 2, 3 & 10]** Gjithashtu, UAMD-ja ka politika dhe mekanizma të efektshme për të siguruar vlerësimin e rregullt të pedagogëve. Studentët marrin pjesë në procesin e vlerësimit. Universiteti ka vënë në zbatim një strukturë të përshtatshme mbështetjeje për të promovuar përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. **[RVV fq. 21; RVV Dok. 1.33, 1.34; Mbledhjet 3-6 & 8-10] [Kapitulli I, Standardi II.1. Kapitulli I, Standardi II.3, Kapitulli I, Standardi II.4]**

4.2 UAMD-ja i pajis studentët që kanë përmbushur kërkesat e programit me një diplomë të miratuar nga universiteti. Studentët kanë informacione për rregulloret e vlerësimit, përfshirë kriteret dhe pritshmëritë e vlerësimit dhe për procedurën e shpalljes së rezultateve. Rezultatet e vlerësimit publikohen pa cenuar parimet dhe pritshmëritë e konfidencialitetit. **[RVV dok. 2.46-2.48] [Kapitulli I, Standardi II.2]**

4.3 Në nivel universiteti, kërkimet dhe puna shkencore drejtohen nga Zëvendës Rektori. Më parë, rezultatet e kërkimeve ishin të kufizuara vetëm te kontributet individuale, përfshirë doktoratura dhe teza të ciklit të dytë, dhe te pjesëmarrja individuale në projekte, artikuj, konferenca dhe veprimtari të tjera të ngjashme. Së fundi, UAMD-ja e ka riorganizuar kërkimin dhe punën shkencore, në mënyrë që të kryhen në shkallë fakulteti. **[RVV fq. 33-35; Mbledhjet 3-6 & 8-10] [Kapitulli II, Standardi I.1]**

4.4 UAMD-ja mbështet dhe nxit kërkime shkencore, që mundësojnë zhvillimin strategjik të vendit, të qarkut dhe të qytetit të Durrësit. Janë shënuar shembuj të projekteve të kërkimeve shkencore të përqendruara në rajon, të lidhura me qytetin dhe zonën përreth. Disa prej projekteve janë zhvilluar dhe në nivel kombëtar. Disa projekte kanë pasur mbështetje të jashtme financiare. Gjithashtu, disa prej projekteve kërkimore përfshijnë bashkëpunimin dhe partneritetin me partnerë të huaj. **[RVV Dok. 2.14, 23 & 60]** Raportet e departamenteve për veprimtaritë kërkimore përfundohen në fund të vitit kalendarik dhe përfshihen në raportin vjetor që universiteti i dërgon Ministrisë. **[Kapitulli II, Standardi I.2]**

4.5 UAMD-ja nxit grupe dhe projekte kërkimore në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian. Universiteti është i angazhuar në organizimin e veprimtarive shkencore. Në përgjithësi, rezultatet shkencore dhe kërkimore bëhen publike përmes metodave të ndryshme. Më së shumti përdoren metodat e prezantimit të kërkimeve në konferenca, seminare, simpoziume, kongrese dhe buletine kërkimore, në nivel universiteti ose të njësisë kryesore. UAMD-ja ka një mekanizëm që merret me mbikëqyrjen e publikimit të rezultateve të kërkimeve. Universiteti boton rregullisht buletin shkencor, Revista IJRD, që përfshin artikuj të punës së bërë nga stafi kërkimor aktiv. Gjithashtu, rezultate të kërkimeve shkencore, që janë të rëndësishme për zhvillimin vendor dhe rajonal, botohen falë partneriteteve dhe institucioneve vendore. **[Mbledhjet 5 & 7] [Kapitulli II, Standardi I.3]**

4.6 UAMD-ja ka hartuar një politikë që parashikon përparësitë e kërkimit shkencor, që përqendrohen në fusha me interes të posaçëm për vendin, qarkun, qytetin dhe universitetin. Këto përfshijnë, zhvillimin e portit të Durrësit si më i madhi në vend, dhe studime mjedisore dhe për turizmin lidhur me ndikimin e portit në qytet dhe zonën përreth. Zakonisht, zbatimi i projekteve të kërkimit shkencor udhëhiqen nga disponueshmëria e kapacitetit mbikëqyrës

akademik dhe nga kërkesa e studentëve. Gjithashtu, vazhdimësia e kërkimeve shkencore mundësohet nëpërmjet përfshirjes së studentëve doktorantë në veprimtaritë kërkimore të departamentit. Kjo përfshin koordinimin e kërkimeve të projekteve dhe tezave me projektet kërkimore për çështje të interesit kombëtar. Veç kësaj, përfshirja e organizatave të partnerëve të huaj në veprimtaritë kërkimore mundësojnë vazhdimësinë e kërkimeve shkencore. UAMD-ja nxit fakultetet dhe departamentet që të ftojnë personel të huaj akademik për të marrë pjesë në veprimtari të mësimdhënies dhe kërkimore. UAMD-ja i publikon në forma të ndryshme rezultatet në fushat e kërkimeve shkencore. **[RVV Dok. 8; Dok. shtesë 1.3 & 1.20; Mbledhjet 1 & 3] [Kapitulli II, Standardi I.5. Kapitulli II, Standardi I.6, Kapitulli II, Standardi I.7, Kapitulli II, Standardi I.8]**

Gjetjet

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikave të mira në këtë Fushë Vlerësimi.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk konfirmoi veprime aktualisht në proces lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Synimi kryesor i UAMD-së për sa i përket rekrutimit, është përmirësimi i cilësisë, dhe jo thjesht shtimi i numrit të studentëve. Kjo do të pasqyrohet në Strategjinë e re të Zhvillimit të universitetit. **[Mbledhja 1]** Është shprehur se kuota e studentëve të universitetit është miratuar nga Këshilli i Fakultetit, mbështetur në propozimet e Ministrisë. **[Mbledhja 3]** Zv/Rektori është përgjegjës për proceset e regjistrimit dhe orientimit të studentëve. Zv/Dekanët e Fakultetit dhe Përgjegjësit e Departamenteve raportojnë tek Zv/Rektori për zbatimin e procesit të rekrutimit dhe orientimit për studentët e rinj. **[Mbledhjet 3 & 8-9]** **[Kapitulli I, Standardi III.1]**

5.2 UAMD-ja është aktive për sa i përket rekrutimit të studentëve në programet e ciklit të parë drejtpërsëdrejti nga shkollat e mesme shqiptare. Universiteti organizon ditë të hapura dhe merr pjesë në panairin vjetor studentor, që organizohet nga Ministria. Për vitin 2015, Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën ka zhvilluar veprimtari promovuese në shkollat e mesme të Durrësit dhe të Tiranës. Po ashtu, në vitin 2015, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit organizoi një javë orientimi për studentët e vitit të parë. **[RVV fq. 36; Mbledhja 5]** Gjithashtu, UAMD-ja bashkëpunon me Drejtorinë Arsimore të Durrësit dhe me palë të tjerë vendore interesi për t'u siguruar që publiku të informohet vazhdimisht për veprimtaritë e universitetit, veçanërisht për ato që lidhen me studentët e mundshëm. **[Mbledhjet 5-6 & 12]** Studentët u shprehën pozitivisht për informacionet e programeve të mundshme të studimit që janë të disponueshme në faqen e internetit të universitetit. **[Mbledhjet 5-6]** **[Kapitulli I, Standardi III.1]**

5.3 Raporti staf/studentë është 37:1, që përlogaritet të jetë raporti i stafit me kohë të plotë/studentë. **[Mbledhjet 8-9]** Studentët dhe stafi nuk e identifikuan si problem numrin e stafit. **[Mbledhjet 5-6 & 8-9]** Stafi ka konfirmuar se universiteti nuk heq dorë nga synimi për të përmbushur standardet e Ministrisë për raportin staf/studentë. **[Kapitulli I, Standardi III.1]**

5.4 UAMD-ja ka një Degë proaktive dhe të efektshme për Këshillimin e Studentëve dhe Alumnit, që ka një rol kyç për sa i përket dhënies së ndihmës në veprimtaritë e orientimit për studentët e rinj. **[Mbledhja 2]** Një rol të rëndësishëm në orientimin e studentëve të ri në programet e tyre e kanë edhe departamentet përkatëse. Gjithashtu, universiteti përdor faqen e internetit dhe tabelat e njoftimit të fakultetit dhe departamenteve për t'i pajisur studentët me informacionet që kërkojnë. UAMD-ja ka një sistem informimi të efektshëm për ruajtjen e informacioneve personale të studentëve. **[Kapitulli I, Standardi III.2]**

5.5 Departamentet janë përgjegjëse për proceset e mentorimit dhe tutorimit. Personeli akademik iu kushton studentëve pesë orë në javë për procesin e tutorimit. Në mënyrë që të mbështetet procesi i tutorimit në të gjithë Universitetin, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit po zhvillon një projekt për të shqyrtuar se sa i efektshëm është sistemi aktual. **[Mbledhja 3]** Nga diskutimet e zhvilluara me personelin dhe studentët, u konfirmua se marrëveshjet aktuale të orientimit dhe të mentorimit janë të kënaqshme. **[Mbledhjet 5-6 & 8-9]** **[Kapitulli I, Standardi III.3]**

5.6 UAMD-ja siguron nivele të përshtatshme mbështetjeje për kategoritë e veçanta sociale. Politikat dhe procedurat e universitetit janë të përqendruara kryesisht në përjashtimin nga apo reduktimin e tarifës shkollore për studentë të caktuar dhe kjo bëhet në përputhje të plotë me kërkesat dhe pritshmëritë e Ministrisë. Këshilli i Ministrave përcakton numrin e bursave të disponueshme në vit. **[Mbledhja 4]** U zbulua se në procesin e buxhetimit financiar, universiteti ka një fond të posaçëm për aktivitetet shoqërore dhe sportive të studentëve. **[Kapitulli I, Standardi III.4]**

5.7 UAMD-ja ofron tekste shkollore cilësore në gjuhën shqipe dhe të huaj në tre bibliotekat kryesore, po ashtu edhe në bibliotekat e fakulteteve dhe departamenteve. Biblioteka

bashkëpunon me fakultetet dhe departamentet për të siguruar që të bëhet përditësimi i stokut të librave. Gjithashtu, studentët janë pyetur edhe për stokun e librave. Personeli pohon se kufizimet financiare kufizojnë numrin e teksteve në gjuhën angleze me të cilat mund të pajisen studentët dhe zakonisht janë të disponueshme vetëm dy kopje të çdo teksti në gjuhën angleze. **[Mbledhja 4]** Biblioteka ofron kurse formimi për të ndihmuar studentët që të kërkojnë dhe të gjejnë informacion akademik në internet. Studentët u shprehën se janë të kënaqur me faktin që tekstet janë të disponueshëm dhe kanë thënë se në rast se një tekst në format të shtypur nuk gjendet, informacione rreth tij mund të kërkohen në internet. **[Mbledhjet 5-6] [Kapitulli I ,Standardi III.5]**

5.8 Përpos proceseve të tutorimit formal, kontakti i përditshëm midis pedagogut dhe studentit iu mundëson studentëve të ciklit të parë mundësi të mëtejshme për mbështetje dhe progres. Mentorimi i veçantë iu ofrohet studentëve të vitit të tretë të ciklit të parë, për t'i mbështetur gjatës zgjedhjes dhe hartimit të diplomës dhe për t'i këshilluar për mundësitë e punësimit në të ardhmen. Gjithashtu, studentëve iu jepen këshilla dhe udhëzime para dhe gjatë praktikës profesionale apo mundësive të praktikës dhe ata shoqëron nga një pedagog në takimin e tyre të parë me ofruesin e praktikës. Ata mbështeten edhe për sa i përket mundësive të studimeve të ardhshme në programet e ciklit të dytë. **[REV fq. 38&39; Mbledhjet 3, 5-6, 8-9 &10] [Kapitulli I, Standardi III.6]**

5.9 UAMD-ja nxit dhe mbështet pjesëmarrjen e studentëve në jetën Universitare. Studentët kanë Këshill Studentor ku mund të diskutojnë për çështje të ndryshme dhe të ngrenë problemet, të cilat përfaqësuesit studentorë duhet t'ua paraqesin Këshillave të Fakultetit dhe Senatit Akademik për zgjidhje. Këshilli Studentor organizon veprimtari të ndryshme dhe trajton problemet e ngritura nga studentët gjatë vitit akademik. **[RVV fq. 39; Mbledhjet 5-6 & 8-9]** Universiteti i ofron Këshillit Studentor një zyrë, pajisjet e nevojshme dhe financim. Studentët janë të përfshirë aktivisht në zgjedhjen e Rektorit dhe të emëruarve të tjerë të nivelit të lartë, dhe japin kontribut për procesin e vlerësimit të cilësisë. Faqet e internetit të fakulteteve kanë portale për studentin. Studentët u shprehën se janë të kënaqur që i janë kërkuar dhe marrë seriozisht mendimet, dhe që janë ndërmarrë veprime të efektshme bazuar në to kur ka qenë praktike apo e arsyeshme. Megjithatë, disa studentë janë shprehur se nuk ishin në dijeni se kush i përfaqëson. **[Mbledhjet 5-6 & 8-9] [Kapitulli I, Standardi III.7]**

5.10 AMU ndjek një politikë mbështetëse të efektshme dhe të përshtatshme për të siguruar cilësinë e jetës studentore në veprimtaritë kulturore dhe sportive. UAMD-ja nuk i ofron studentëve akomodim. Gjithashtu, universiteti nuk ofron transport të subvencionuar brenda njësisë vendore për personelin ose studentët. **[Dok. i anketimit të studentëve; Mbledhjet 5-6]** Personeli u shpreh se asnjëra prej çështjeve nuk mbulohej nga buxheti i universitetit dhe se akomodimi dhe ndihma financiare për studentë ofrohet nga një shoqëri e veçantë në përputhje me kërkesat e Ministrisë. **[Mbledhjet 8-9] [Kapitulli I ,Standardi III.8]**

5.11 Punësimi i studentëve ka rëndësi të veçantë për Universitetin, ndaj UAMD-ja ka vënë në zbatim procese të efektshme për t'iu ardhur në ndihmë studentëve që të punësohen dhe që të bëjnë praktikën gjatë vitit të tretë të programeve të tyre të ciklit të parë. **[RVV fq. 18; RVV dok. 1.67, 1.68 & 3.11.3]** Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit është përgjegjëse për ndjekjen e vendeve ku janë punësuar të diplomuarit dhe u konstatua se Fakulteti i Biznesit ka një bazë të dhënash për institucionet ku studentët fillojnë praktika dhe ku të diplomuarit punësohen. Kjo shoqërohet nga projekte të organizuara në partneritet me Bashkinë e Durrësit gjatë muajve të verës, ku studentët kanë mundësinë të marrin pjesë në punë vullnetare vendore. U konstatua se pjesëmarrja në aktivitete të tilla ka mundësuar që studentët të punësohen nga organizatat e përfshira dhe ka rritur profilin e Universitetit brenda komunitetit vendor. **[Mbledhjet 3-6, 8-10 & 12]** Studentët u shprehën se kanë shumë mundësi zgjedhjeje për sa i përket praktikave të mundshme apo mundësive të punës praktike, dhe se punësimi ishte thujse i sigurt pas një praktike dhe diplomimi të

suksesshëm. Megjithatë, disa studentë të fakultetit të biznesit u shprehën se mundësitë e praktikës nuk aq të disponueshme sa në fusha të tjera. **[Mbledhjet 5-6] [Kapitulli I, Standardi III.9]**

Gjetjet**Praktikat e mira**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikave të mira në këtë Fushë Vlerësimi.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk konfirmoi veprime aktualisht në proces lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.